

SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE 2021

➤ TE PERGJITHSHME

HISTORIA DHE KRIJIMI

Shoqeria BLOJA SHA funksionon si shoqeri ANONIME mbi bazen e Ligjit "Mbi shoqerite tregtare ".Ajo eshte krijuar 02/08/1995 me vendim nr 11826 te Gjykates se rrethit Tirane .

Kuotat e kapitalit zoterohen nga individet Fuad Haxhiymeri 45.695% ,Agron Haxhiymeri 45.695% dhe te tjere individe dhe Ministria e Ekonomise

Aktiviteti I saj eshte eshte 1,209,658,000

➤ PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

• Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (S.K.K) .

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e parimit te kosos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara.

Pasqyrat financiare te shoqerise pergatiten cdo vit per daten 31 Dhjetor .

• Nje permbledhje e politikave kryesore kontabel eshte paraqitur me poshte:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri.

Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara.

Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kosos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2021 jane :

EURO : LEK 121.76

USD : LEK 108.17

• **Kostot e huamarrjes**

Kostot e huamarrjes perfshijne interesin e paradhenieve bankare dhe huave afatshkurtera dhe afatgjata. Kostot e huamarrjes njihen si shpenzim ne periudhen qe ato jane shkaktuar pavarsisht se si huate jane aplikuar .

- **Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem per vitin . Fitimi i tatueshem ndryshon nga fitimi neto qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sepse ai perjashton zera te te ardhurave dhe shpenzimeve qe jane te tatueshme apo te zbritshem ne vite te tjere dhe gjithashtu perjashton zera qe nuk jane kurre te tatueshem apo te zbritshem . Detyrimi i shoqerise per tatim fitimin e vitit llogaritet duke perdorur normat e tatimit te percaktuara nga legjislacioni shqiptar per kontabilitetin ne Shqiperi . Norma aktuale e tatimit mbi fitimin eshte 15 %

- **Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

- **Detyrimet financiare**

Detyrimet financiare janë klasifikuar sipas llojit të marrveshjes kontraktuale.

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

- **Risku i kreditimit**

Risku i kreditimit të Shoqerise kryesisht i vishet kerkesave per arketim dhe aktiveve te tjera te saj . Gjendjet e paraqitura ne bilancin kontabel zvogelohen nga provigjonet (shumat e parashikuara) per kerkesat e dyshimta per arketim , te vleresuara nga drejtimi i shoqerise mbi bazen e experiences se meparshme dhe vleresimit te mjedisit ekonomik actual .Shoqeria nuka ka kerkesa te dyshimta dhe nuk ka krijuar provigjone te tilla.

Shoqeria nuk ka perqendrim te rendesishem te riskut te kreditimit , me nje zbulim te shperndare ne nje numur te madh te tretesh dhe klientesh .

- **Aktivet afatgjata materiale (AAM-te)**

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten me shuma të rivleresuara minus zhvleresimin . Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin “tepricë nga rivlerësimi”. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi është llogaritur mbi bazen e normave fiskale -

- Pajisjet elektronike (aparaturat mjeksore elektronike) 25% me vlere te mbetur.
- Te tjerat 20%

- **Inventaret**

Inventaret janë paraqitur me kosto historike pasi vlera neto e realizueshme nuk mund të percaktohet. Kosto perbehet nga kosto e blerjes direkte , tarifat doganore dhe tarifat e transportit. Per ndjekjen dhe inventarizimin e materialeve eshte perdorur metoda e kostos mesatare .

- **Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)**

Gjendjet e llogarive të likujditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhenat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepërcat e shprehura në monedhë të huaj, janë konvertuar në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të bankës së Shqipërisë.

Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Shumat e paraqitura në "Llogari / Të drejta nga aktiviteti shfrytëzimit paraqet vlerën e pa likuiduar në 31.12.2021.

Drejtimi mendon se të gjitha kërkesat do të arketohen në një periudhë afatshkurter me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

- **Aktivet Afatgjata Materiale (AAM-te)**

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare paraqitet në pasqyrën bashkangjitur.

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mesipërme janë të perputhura me të dhenat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit dhjetor 2021. Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SNK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar.

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë ushtrim kontabel, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritje zhvlerësime.

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë të njëjta me ato që përdoren për qëllime fiskale. Masa e llogaritjeve të amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijtë e njohur për efektë fiskale. Drejtimi ka cmuar shumën e amortizimit të kaluar në shpenzime si shumën e drejtë.

- **Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet**

"Të pagueshme ndaj furnitoreve" përbehet nga detyrimi i papaguar ndaj furnitoreve deri në 31.12.2021 për të cilat është përgatitur inventari përkatës.

"Detyrimet tatimore" përfaqësojnë detyrimet për detyrimet e muajit dhjetor 2021. Të gjitha këto detyrime janë shlyer në muajin Janar 2022.

"Detyrime ndaj ortakëve" përfaqësojnë detyrimet ndaj ortakut për hua të perkohshme.

Drejtimi mendon se të gjitha të pagueshmet ndaj të tregëve do të likuidohen në një periudhë afatshkurter me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

- **Kapitalet e veta**

Kapitali i rregjistruar i shoqërisë, i paraqitur në bilanc, është i njëjti me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet 1000/ pjesë.

- **Te ardhurat**

Të ardhurat nga shitja e mallrave janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Paraqitja në pasqyrat financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre. Të ardhurat janë të relizuara nga shërbimi i Rrobaqepsi, ato janë të përjashtuara nga tvsh.

- **Shpenzimet e veprimtarisë kryesore**

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë rregjistruar me shumën e paguar ose të pagueshme.

natyres se tyre. Te ardhurat jane te relizuara nga sherbimi i diagnostikimit , ato jane te perjashtuara nga tvsh .

- **Shpenzimet e veprimtarise kryesore**

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme.

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit.

- **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

- **Shpenzimet e tatimit mbi fitimin** Tatim fitimi i ushtrimit eshte llogaritur mbi fitimin fiskal i cili eshte llogaritur duke korektuar fitimin e ushtrimit me shpenzimet e pa njohura.

Të tjera

Pasqyra e Fluksit Monetar te vitit 2021 është e ndërtuar me metodën indirekte në përputhje me SKK-e permirsuara.

Pasqyra e ndryshimit në kapital është ndërtuar në përputhje me SKK-të dhe është e barabartë me rubrikën Kapitali, në Pasivet në Bilancin kontabël , pjesë e Pasqyrave Financiare.

Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimsia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e redeshme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

Agron HAXHIYMERI

Fuad HAXHIYMERI

